



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4869 Prot

Gramsh më 07-01-2021  
12.2020

V E N D I M

Nr. 86 dt. 28/12/2020

“ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Hamza Tervoli, banues në fshatin Liras, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblim financiar”.

Këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28/12/2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit : “ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Hamza Tervoli, banues në fshatin Liras, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblim financiar”, bazuar në :

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $2\ 785\ 555 \times 50\% = 1\ 392\ 778$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Hamza Tervoli** është në **1 392 778** (një milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **1 392 778** (një milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, për shtetasin **Z. Hamza Tervoli**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektor i Emergjencave Civile ).
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**XHULIA GJINI**

Konceptoi: Xh. Gjini  
Miratoi : G.Lena  
Pranoi: G.Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**GRETA LENA**

